



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Data/Datum/Date:	23.12.2022
Nr./Br./No	02/859
Për/Za/To:	Publikim në portalin shtetëror të konkurseve
Nga/Od/From:	Qemajl Aliu, kryetar i Komunës
Lënda/Predmet/Subject :	VENDIM

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020, në bazë të rekomandimit nga Drejtoria e Arsimit me nr.05/964 të datës 22.12.2022 dhe në bazë të raportit nga Komisioni Përzgjedhës për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve me nr.prot.05/964 të datës 22.12.2022, kryetari i Komunës merr:

VENDIM

- Anulohet konkursi për zëvendës drejtor në Institucionin për Arsim dhe Aftësim Profesional në Shtime (përsëritje e konkursit) me nr të referencës së rekrutimit 05-111/01/29748/22 dhe me nr të protokollit 05/822 i datës 18.10.2022
- Vendimi hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit

ARSYETIM

Këtij vendimi i ka paraprirë rekomandimi i Drejtorisë Komunale të Arsimit me numër protokollit 05/972 i datës 23. 12. 2022 i bazuar në raportin (formularin "b") me numër protokollit 05/964 i datës 22. 12. 2022 nga komisioni përzgjedhës në të cilin është konstatuar se në procedurën e rekrutimit për zëvendës drejtor në Institucionin për Arsim dhe Aftësim Profesional në Shtime ka aplikuar vetëm një kandidat i cili nuk e plotëson njërin nga kriteret/kushtet e konkursit që parashihet në Udhëzimin Administrativ të MASHT NR.151/2020 përkatësisht nenin 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1.

Këshillë juridike: pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë të paraqes ankesë pranë komisionit për shqyrtimin e ankesave për sektorin e arsimit në komunën e Shtimes